



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 287 Prot.

Pogradec, më 23.06 2022


VENDIM

Nr. 63, DATË 22.06.2022

PËR

MIRATIMIN ME SHKRIM PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR TË NJË SIPËRFAQEJE PYJORE PREJ 13.11 HA NË EKONOMINË PYJORE MOKËR 1, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL, NË OBJEKTIN “RODOKALI VERIOR DHE JUGOR, ME KËRKESE TË SUBJEKTIT “MINING FERRO NIKEL” SHPK.

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 “Koncepti i autonomisë vendore” dhe nenit 4 “Rëndësia e autonomies vendore”, të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e “Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”, pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gërmës “e” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, “Për Pyjet”, Ligjit Nr.10304, date 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në V.K.M Nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, dhe ishkomunave/bashkive”, shkronjës “ç” të pikës 5 të vendimit Nr.1353 date 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor publik” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Nr.511 Prot, datë 16.01.2020 “Për përgatitje të raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit mineral”, Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Pogradec Nr.31, datë 24.01.2022, “Mbi hartimin e raportit tekniko – ekonomik, për heqjen nga fondi pyjor/kullor në pronësi të Bashkisë”, të sipërfaqes prej 13.11 Ha, në Ekonominë Pyjore Mokër 1, në pronësi të Bashkisë Pogradec, “Për shfrytëzimin e mineralit të Hekur–Nikelit në objektin “Rodokali Verior dhe Jugor” nga subjekti “Mining Ferro Nikel” Shpk, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak.



VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej **13.11 ha** pylli në ekonominë pyjore Moker 1, sipërfaqe e cila do ti nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor për ushtrimin e veprimtarisë minerare shfrytëzim hekur-nikeli, me kërkesë të subjektit **“Mining Ferro Nikel” Shpk.**
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Shërbimi Pyjor për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").
4. U shpall sot më datë 22.06.2022.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI



4543500

4544000

4544500

4545000

